

L I G J
Nr.7855, datë 29.7.1994

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7501, DATË 29.4.1991 “PËR TOKËN”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Pas nenit 5 të ligjit 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, shtohet neni 5-a me këtë përmbajtje:
“Komisionet e Tokave të fshatrave dorëzojnë dokumentacionin e ndarjes së tokës në seksionin e kadastrës të rrethit sipas dispozitave dhe kritereve të përcaktuara”.

Neni 2

Pas nenit 23 shtohet neni 23-a me këtë përmbajtje:
“Komisionet që veprojnë në kundërshtim me nenin 1 të këtij ligji dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore për plotësimin e dokumentacionit të ndarjes së tokës, kur këto veprime nuk formojnë vepra penale, çdo anëtar i komisionit i çdo niveli në vartësi të shkallës të përgjegjësisë, dënohet për kundravajtje administrative nga 2000 deri 5000 lekë.

Gjobat vendosen nga kryetari i këshillit të rrethit në cilësinë e kryetarit të komisionit të tokave të rrethit.

Vendimi është i formës së prerë.

Neni 3

Në rast se edhe pas kësaj mase kryetari dhe sekretari i komisionit nuk dorëzojnë dokumentet, denoncohen për ndjekje penale nga komisioni i tokave të rrethit për shpërdorim detyre.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.909, datë 16.8.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha